R E Z O L U T Ë

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
PËR VITIN 2005

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe përkrahur veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si një institucion kushtetues, që merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e procesit zgjedhor;

- duke mbështetur dhe realizuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për kuadrin e domosdoshëm ligjor për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike;

- duke vlerësuar rolin dhe kontributin e të gjitha forcave politike për krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë e të ligjshëm;

pasi u njoh me Raportin Vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2005, në bazë të nenit 29 pika 9 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.9371, datë 14.4.2005 dhe nenit 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

konstatoi se:

- KQZ-ja bëri përpjekje që procesi zgjedhor të administrohej në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor, por pothuajse të gjitha afatet e parashikuara në Kod gjatë këtij procesi nuk u arritën të respektohen;

- për shkak të moskrijimit të listave të sakta të zgjedhësve dhe mospërditësimit të tyre nga KQZ-ja, Kuvendi ia kaloi këtë detyrim ekzekutivit, edhe pse administrimi i zgjedhjeve është detyrim kushtetues i KQZ-së;

- veprimtaria monitoruese e KQZ-së për mbikëqyrjen e Kodit Zgjedhor nga media bëri që pasqyrimi i fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore të ishte përgjithësisht i ekuilibruar dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore;

- procesi ishte i tejzgjatur dhe ndonjëherë i pasigurt, për shkak të debateve dhe parregullsive të shumta në disa zona që shkaktoi numërimi i votave;

-në disa raste KQZ-ja ka shfaqur mungesë vullneti për të shfrytëzuar plotësisht kompetencat e veta hetimore, për t'u dhënë një zgjidhje të drejtë ligjore ankesave para dhe paszgjedhore;

Kuvendi kërkon që për vitin 2006 t'u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- të angazhohet maksimalisht për zbatimin e legjislacionit zgjedhor për organizimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të ardhshme vendore;

- të mbajë në qendër të vëmendjes rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës zgjedhore, kushteve të punës të komisioneve zgjedhore dhe identifikimin e nevojave logjistike për funksionimin normal të tyre gjatë procesit të ardhshëm zgjedhor;

- të ngrejë në një nivel më të lartë bashkëpunimin me organet e qeverisjes qendrore e vendore;

- t'u kushtojë më shumë vëmendje komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta, me qëllim aftësimin e tyre profesional mbi bazë trajnimesh të vazhdueshme;

- të njoftojë partitë politike kur merret vendim për kërkesat e tyre për regjistrim;

- KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor nuk duhet të kufizohen pa arsye për llojin e fakteve që mund të marrin në konsideratë gjatë ankimeve zgjedhore;

- të ketë më shumë orientim për veprimet që duhet të marrë në lidhje me kutitë e parregullta të dërguara nga KZZ-ja dhe qartësi më të madhe për rrethanat në të cilat duhet të ndërmarrë një numërim "të parë" të votave, pavarësisht nëse kutitë janë gjykuar të parregullta ose jo;

- të hartojë një axhendë të detajuar për organizimin e zgjedhjeve vendore dhe të kontrollojë zbatimin e kësaj axhende.

Tiranë, më 4.5.2006